



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 192 dt.20.10.1994

MBI
FINANCIMIN NGA FONDI REZERVE TE JETIMEVE DHE
RIKONSTRUKSIONIN E SHKOLLAVE NE KONVIKT

Këshilli Bashkiak i Qytetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.20.10.1994, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Arsimit për financimin nga fondi rezervë të kuotës së ushqimit të jetimëve që kanë mbaruar shkollën, që trajtohen në konviktet si dhe rikonstruksionin e disa shkollave në konvikt

VENDOSI

1. Çeljen e fondit prej 700.000 lekë për përballimin e ushqimit të fëmijëve jetimë.
2. Çeljen e fondit prej 2.500.000 lekë të shkollave me konvikt.
3. Ngarkohet Seksioni i Arsimit të bëjë ndarjen e këtij fondi në këto shkolla sipas nevojave.
4. Ngarkohet ky seksion dhe Drejtoria e Administrimit Financiar për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

KRYETARI

BESNIK PETRELA